Me pak fjalë, hapi i parë ofron informata relevante për secilën fushë kyçe të AZHQ-së, potencon problemet dhe vë në pah mundësitë zhvillimore dhe lokacionin e tyre.




Figura 3-2: Objektivat e zhvillimit hapësinor: nga vlerësimi i AZHQ për resurse në Udhëzues AZHQ

3.3. Hapi 3 – Objektivat e zhvillimit hapësinor

Objektivi më i duhuri zhvillimor varet nga kombinimi i këtyre katër faktorëve në një situatë të caktuar dhe në një lokacion të caktuar. Në përgjithësi, kemi tri objektiva të ndryshëm të zhvillimit të qëndrueshëm:

1. Resurset me **funksione të rëndësishme mirëpo aktualisht të cilësisë së varfër/dobët** (të ndotura, të degraduara, të pamjaftueshme, etj) kanë nevojë të **rehabilitimit/avancimit**. Kjo mund të vlejë për tokën e cila ka pësuar erozion, ujërat e ndotur, lidhjet e këqija rrugore, apo shkollat me pajisje të dobëta. Me shtytjen e zhvillimit synohet restaurimi i resurseve, në mënyrë që ato t'i shërbejnë optimalisht shoqërisë, natyrës dhe/ose ekonomisë;
2. Resurset të cilat janë **shumë të ndjeshme dhe të rëndësishme së lartë** për natyrën dhe shoqërinë kanë nevojë për **mbrojtje**. Kjo duhet të bërë për të siguruar se janë në dispozicion për brezin aktuale dhe për brezat e ardhshëm;
3. Resurset **në sasi të madhe dhe me cilësi të mirë** duhet të **zhvillohen** për t'u shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme. Mbi-shfrytëzimi duhet të evitohet, pragu i ndjeshmërisë nuk duhet të kalohet dhe shfrytëzimi duhet të bëhet në të mirën e shoqërisë. Shfrytëzimi i qëndrueshëm poashtu përfshin edhe koordinimin e konflikteve. Konfliktet e tilla mund të shfaqen nëse kërkesat e ndryshme për një resurs janë në konflikt me njëra-tjetrën. Në raste të tilla duhet të gjendet një kompromis i drejtë dhe i arsyeshëm.

Është e qartë se udhëzimet duhet vlerësuar: ato kërkojnë deklarata normative apo gjyquese se a janë të mira apo të këqija, relevante apo më pak relevante, dhe tjera të ngjashme. Për çdo resurs duhet të përkufizohet sasia e mjaftueshme, cilësia e mire, funksioni i rëndësishëm apo ndjeshmëria e caktuar. Kjo arrihet përmes krahasimit kundrejt standardeve, kundrejt objektivave kuantitativ zhvillimor, etj. Për çdo fushë kyçe të AZHQ-së është hartuar një qasje vlerësuese në formë të një **peme vendimi**. Këto procedura vlerësuese reflektojnë politikat dhe objektivat e nënvizuara të Zhvillimit të Qëndrueshëm, synimet kombëtare dhe provinciale si dhe njohuritë shkencore.

3.4. Hapi 4 – Integrimi i objektivave të zhvillimit hapësinor

Në këtë hap të fundit përkufizohen rekomandimet efikase duke pasur parasysh rezultatet e hapit 3. Integrimi i objektivave të zhvillimit hapësinor të fushave të ndryshme zhvillimore kërkon vendimin mbi prioritetet. Në radhën e këtyre prioritetëve janë planifikimet gjithështrirëse kombëtare apo regjionale, janë qëllimet zhvillimore të komunës dhe vendimi politik nga administrata përgjegjëse dhe nga komunitetet. Mirëpo, kufizimet teknike luajnë një rol të rëndësishëm. Dy shembuj shpjegojnë këtë pikë: 1) vendet me tendencë erozioni nuk janë të përshtatshme për shfrytëzimin e tillë të tokës që favorizon erozionet, edhe nëse ka vullnet politik. 2) Dheu me përmbajtje të shkëlqyeshme për bujqësi është poashtu i shkëlqyeshëm edhe për pyje, mirëpo prioritet mund t'i jepet sektorit të bujqësisë.

Hartat e integruara janë një pjesë e rëndësishme e Vlerësimit Strategjik Mjedisor i cili udhëzon Planit e Komunës për Zhvillim, duke sugjeruar rezistence hapësinor të zonave të zonave të ndryshme dhe duke mbështetur përcaktimin e prioritetëve për një zhvillim të qëndrueshëm.

3.5. Koncepti i ndarjes në zona

Prezantimi i rezultateve të këtij atlasi bazohen në konceptin e ndarjes në zona, një qasje e cila është krijuar për qëllime të menaxhimit të shfrytëzimit të tokës. I referohet nën-ndarjes së një vendi të planifikuar në nën-vende diskret të një funksioni të caktuar (“zonat”). Zonat tipike janë zonat mbrojtëse (për shembull, zonat e rezervave natyrore apo zona mbrojtëse të ujit) apo zona për zhvillim (p.sh. zona për zgjerim urban apo zhvillim industrial, apo zona për rryllëzim).

Qëllimi i ndarjes në zona është rregullimi i shfrytëzimit të tokës në një zonë në mënyrë të tillë që të sigurohet funksioni i zonës. Rregulloret e shfrytëzimit të tokës rëndom përfshijnë:

- Dispozita se disa shfrytëzime të caktuara duhet patjetër të bëhen (p.sh. mbjellja e pemëve në zonat e ndara si tokë pyjore),
- Leje për shfrytëzime të caktuara të cilat mund të ndodhin (një rrugë mund të ndërtohen në zonat e ndara si tokë pyjore), si dhe
- Ndalesa për shfrytëzimet tjera të cilat nuk lejohen të bëhen (rëndom, zhvillimi industrial nuk lejohet në zonat e ndara si tokë pyjore).

Shënjimi i kufijve të zonës mund të bazohet në kufijtë administrativ apo në karakteristikat natyrore hapësinore (p.sh. ndarjet me ujë) apo në kombinim të dyjave. P.sh. potenciali i rryllëzimit mund të përkufizohet përmes një regjimi specifik klimatik dhe me përmbajtje të caktuar të dheut në kuadër të një njësie administrative, p.sh. një qarku. Për të qenë efektive, rregulloret e shfrytëzimit të tokës duhet të respektohet pavarësisht pronësisë.

Rezultatet e atlasit janë të prezantuara si një varg hartash tematike:


Hartat B për hapin 1 (hartimi i të dhënave bazike): të gjitha informatat e kërkuara vendosen në hartat tematike. Informatat bazike topografike dhe ato tematike përdoren për vlerësimin e resursit në Hapin 2.

Hartat A për hapin 2 (vlerësimi i resursit): Zonat me deficit dhe potencial zhvillimor, përfshirë edhe problemet e zonave (ndotja, degradimi), zonat e resurseve potenciale apo me resurse me ndjeshmëri të lartë. Në i përmbledhim ato si **zona të vlerësimit të resursit**. Ato janë të vendosura për hartë individualisht për çdo fushë kyçe të AZHQ.

Harta G për hapin 3 (objektivat zhvillimor): Zonat të cilat shpalosin objektivat më të duhura zhvillimore. Kriteret transparente të vendim-marrjes dhe logjikisht të strukturuar përdoren për të përmbyllur objektivat zhvillimore. (**Figura 3-3** jep një shembull të “Pemës së Vendimit” për të nxjerrë zonat e ndryshme). **Zonat e objektivave zhvillimore** përbëhen nga:

- **Zonat e rehabilitimit:** tregojnë zonat të cilat kanë nevojë të përmirësimit/avancimit të menjëhershëm. Kjo ngase statusi i saj aktual pengon procesin zhvillimor. Në këto rehabilitimi është çështje dominante zhvillimore.
- **Zonat për mbrojtje:** tregojnë zonat të cilat kanë nevojë për prezervim apo mbrojtje në mënyrë që të sigurohet funksioni i saj për gjeneratën e tanishme dhe brezave që do vijjnë. Në këto zona mbrojtja është çështje dominante dhe shfrytëzimet tjera në këto zona duhet të harmonizohen me këtë objektiv. Ju lutem keni parasysh se “mbrojtja” nuk nënkuptohet në kuptimin ligjor, por si kategori planifikimi.
- **Zonat për zhvillim:** tregojnë zonat të cilat kanë potencial për zhvillim të qëndrueshëm. Pas një balancimi të kujdesshëm në mes të konflikteve të mundshme të kërkesave të fushave të ndryshme kyçe të AZHQ, identifikohet lloji më i mirë i zhvillimit.

Figura 3-3: Pema e vendimit për resursin kyç “pyllin”.



(*) – duke marr parasysh vetëm direktivave e habitatit – Shtojca 1 ngel pa pyje zabel

Shpjegim - CORINE

- 1 Sipërfaqe artificiale
- 3.1 Pyje
- 3.2.4 Tokë pyjore/shkurre transitore
- 3.2.5 Tokëpyjore/shkurre transitore

Figura 3-4: Fragment i hartës udhëzuese AZHQ për resursin kyç “Pyllin”



Hartat IG për hapin 4 (Hartat e integruara të udhëzimit)

Pas balancimit të konfliktit, këto rezultate janë të integruara në **hartat e integruara të udhëzimit**. Kjo e fundit përfshijnë:

- a) **Rezistencën** e përgjithshme **hapësinore**, të definuar me rezistencë hapësinor shumë të lartë, të lartë, të mesme dhe të ulët. Rezistenca tregon shumë e pjerrtësisë, ashpërsinë e rreziqeve natyrore, bio-diversitetin, shfrytëzimet e veçanta të tokës, funksionet pyjore, begatinë e dheut dhe mbrojtjen e zonave natyrore (Parku Kombëtar). Sa më e madhe të jetë rezistenca, aq më shumë konflikte mbi shfrytëzimin e tokës ekzistojnë, të cilat duhet të merren parasysh në planifikimin e infrastrukturës, vendbanimeve dhe shfrytëzime tjera produktive.

dhe

- b) **Struktura funksionale** në formë të qendrave dhe korridoreve zhvillimore.

Korridoret zhvillimore dhe qendrat zhvillimore janë mjete të mëdha për të siguruar një zhvillim mirë të strukturuar dhe të përqendruar të regjionit të planifikuar në një mënyrë të balancuar. Evitohet shtrirja urbane dhe shfrytëzohen efektet e aglomerimit.

Qendrat zhvillimore janë qendrat ku zhvillimi urban (zhvillimi industrial dhe komercial; infrastruktura shoqërore dhe administrative) duhet të përqendrohet. Ato ofrojnë shërbime për vendet rurale dhe për fshatrat përreth, përfshirë shërbime administrative, shëndetësore, tregje dhe shërbime arsimore dhe kulturore. Vendet rurale përreth duhet të kenë qasje të lehtë në këto qendra. Qendrat zhvillimore kanë një hierarki të dallueshme nga qendrat kombëtare dhe provinciale në qendrat e qarkut dhe në fund qendrat rurale zhvillimore.

Qendrat zhvillimore janë të lidhura me **korridoret** zhvillimore. Zhvillimi në të ardhmen dhe investimet në infrastrukturë duhet poashtu të përqendrohen buzë këtyre korridoreve. Rripat e gjelbër dhe zonat sigurojnë integrimin mjedisor të vendbanimeve me një funksion për rekreacion lokal, sigurojnë bufer zonat klimatike lokale dhe korridore relevante ekologjike për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e bio-diversitetit.

Figura 3-5: Fragment i hartës së rezistencës hapësinore





Figure 3-6: Fragment i hartës së strukturës funksionale



3.6. Përmbledhje

Rezultatet e AZHQ-së janë një varg hartash tematike të zonës, përfshirë:

- **Hartat bazë:** për orientim dhe referim, atlasi poashtu përmban harta të rëndësishme bazë të cilat janë informata mbi tokën, klimën, informata gjeologjike, etj.
- **Hartat vlerësuese** tregojnë zonat me probleme (ndotjet, degradimin), zonat me potencial

të resurseve, apo zonat e resurseve me ndjeshmëri të lartë. Ne i përmbledhim ato si zona të vlerësimit të resurseve.

- **Hartat udhëzuese** shpalosin zonat të cilat tregojnë objektivat më të duhur zhvillimor, si mbrojtja, rehabilitimi dhe zhvillimi. Ne i përmbledhim ato si zona udhëzues.
- **Hartat e integruara udhëzuese:** Ka të ngjarë se vendosja e hartave udhëzuese në krye do të vë në pah vende ku zona të ndryshme japin udhëzime konfliktuoze. **Harta e rezistencës hapësinore** jep informata për PZHK se në cilat zona mund të priten konflikte në mes të shfrytëzimeve të ndryshme të tokës. **Harta e strukturës hapësinore** sugjeron një zhvillim të strukturuar komunal, dhe merr parasysh potencialin dhe kufizimet e komunës.

Draft final - për miratim

4. Komuna e Dragashit

Dragashi është komuna më jugore në Kosovë, që kufizohet me IRJ të Maqedonisë në lindje dhe në jug dhe me Shqipërinë në perëndim. Koordinatat e komunës janë 41° 50' 58" - 42° 09' 03" në gjerësinë veriore dhe 20° 35' 39" - 20° 48' 26" në gjatësi. Në very, Dragashi kufizohet me komunën e Prizrenit që është qendra e rajonit të jugut të Kosovës. Qyteti i Dragashit është 37 km larg nga qyteti i Prizrenit.

Komuna mbulon një zonë prej 433,7km², përafërsisht 4% të tërë territorit të Kosovës dhe është komuna e tetë më e madhja nga 30 komunat e Kosovës. Komuna e Dragashit/Dragaš përbën 35 vendbanime me qytetin e vogël të Dragashit si qendra e komunës. Në anët e saja jugore dhe lindore komuna kufizohet nga malet e larta të Sharrit, që shtrihen në FYROM dhe Shqipëri. Ky varg i maleve zgjatet në verilindje-jugperëndim për afërsisht 70km në gjatësi dhe 30 km në gjerësi, me një zonë sipërfaqësore gjithsejt prej afërsisht 1600km². 900km² (56.25%) e kësaj zone shtrihet në FYROM, me 690 km² (43.12%) në Kosovë dhe 10 km² (0.63%) në Shqipëri. Një karakteristikë e veçantë e Dragashit janë fushat e gjera të kullosave që kanë bërë këtë zonë të përshtatshme për fermë të bagëtive, bujqësi dhe produkte bujqësore.

Vargmalet e Sharrit në Kosovë ndahen në tre rajone që përbëjnë zonat dimërore dhe zonat turistike të Lubotenit/Brezovicë, zonën qendrore të Prizrenit, dhe pjesën e Dragashit që përbën Gorën dhe Opojën. 18.5% e këtij vargmali është mbi 2000m lartësi mbidetare. Mali më i lartë i tërë zonës së Sharrit është mali Korab (2764m), ndërsa maja më e lartë është Maja e Titos deri në 2747m. Në Dragash majat më të rëndësishme janë: Koritnik në veriperëndim në kufi me Shqipërinë (2262m), Kodra e Karanikolles në verilindje (2409m), Maje në lindje (2493m), Kryet e Kagit në veri të Brod (2207m), Vraca e Madhe në juglindje (2536m, pika më e lartë) dhe Kësula e Priftit në jug-perëndim (2075m). Në aspektin topografik Dragashi mund të ndahet në nën-pellgjet lumore të veta kryesore: me lumin Restelicë, lumin Pllavë (në rajonin e Opojës, përfshirë pjesët lindore të zonës malore të Sharrit në Dragash), dhe Lepencin (në pjesën jugore të komunës). Sistemi i katërt shtrihet rreth Breznes, ku zona vazhdon të rrjedhë nëpërmjet një strukture karstike nëntokësore në zonën e Prizrenit. Dy nga këto rrjedha kryesore të ujit i takojnë në pjesën më të madhe pellgut të lumit Drini i Bardhë duke kaluar nëpër Shqipëri dhe në detin Adriatik: lumi Pllavë me degët e veta në veri, dhe lumi Restelicë që rrjedh në lumin Pllavë. E treta rrjedhë kryesore e ujit – pellgu i lumit Lepenc – shtrihet në jug dhe rrjedh kryesisht nëpër IRJ të Maqedonisë në detin Egje.

Megjithatë, territori më shpesh identifikohet në atë mënyrë që përbën dy zona, atë të Opojës në veri dhe të Gorës në jug. Gjeografia kodrinoro-malore ka ndikuar në zhvillimin e vogël, të përqëndruar të vendbanimeve rurale fshatare përgjatë tre luginave kryesore, por gjithashtu kjo është arsye e izolimit të komunës dhe infrastrukturës së tanishme dhe problemeve tjera. Sipas profilit të pjerrtësisë, 55% e territorit është i cilësuar si i rrëpirët ose shumë i rrëpirët, dhe gjegjësisht ofron qasje të limituar ose aspak qasje për makinat. Kjo kufizon mundësitë për bujqësi si dhe për zgjerimin e rrugëve dhe vendbanimeve.

Lartësia e komunës ndryshon ndërmjet 750 dhe 2550 m mbi nivelin e detit, me mesataren që shtrihet në 1620 m. Pjesa më e madhe e territorit - 40.3% – klasifikohet si "Mal i lartë" me një lartësi ndërmjet 1450m dhe 2050m. Vargu i malit në veri të komunës arrin lartësinë ndërmjet 1100 m dhe 2200 m. 30.4% të zonës shtrihet në rajonin malor (1050 – 1350 m mbi nivelin e detit), me 20.3% të gjithë zonës që janë dukshëm më të larta dhe shtrihen në lartësi nga 2050 deri në 2550 m, nivel në të cilin drunjtë nuk rriten (kufiri i rritjes së druve). Vetëm 6% e territorit është nën-malor (2600 ha në lartësi 750 – 1050 m lartësi mbidetare), e vendosur në veri rreth luginës së Pllavës, dhe pjesët më të ulta të luginave të Brodit dhe lumit Restelicë. Kjo tregon që komuna në përgjithësi ka lartësi të lartë dhe posaçërisht lartësi malore kur krahasohet me lartësinë mesatare të tërë Kosovës që është 800 m lartësi mbidetare. Komuna fqinje e Prizrenit ka lartësinë mesatare mbidetare 400 – 500 m.

³ Territori i Dragashit pas rregullimit të kufijve në vitin 2012.

5. Hartat për Atlasin për Zhvillim të Qëndrueshëm 1 : 30 000

Table 5-1: Lista e Hartave AZhQ

B	Hartat themelore
	Përmbledhje për komunën e Dragashit
B1	<ul style="list-style-type: none"> B1.1 Përmbledhja e komunës B1.2 Harta topografike e komunës
B2	Popullata dhe vendbanimet
B3	Gjeologjia dhe burimet minerale
B4	Toka
B5	Kilma
B6	Burimet e ujit
	Përdorimi i vërtetë i tokës
B7	<ul style="list-style-type: none"> B7.1 Përdorimi i vërtetë i tokës B7.2 Përdorimi i veçantë i tokës
B8	Burimet e biosferës – vegjetacioni
B9	Burimet e biosferës – fauna
A	Hartat e vlerësimit
A1	Vlerësimi dhe biodiversiteti <ul style="list-style-type: none"> A1.1 Vlerësimi i biodiversitetit – vegjetacioni dhe flora A1.2 Vlerësimi i biodiversitetit - fauna
A2	Zgjerimi i Parkut Kombëtar “Sharri” <ul style="list-style-type: none"> A2.1 Parku Kombëtar “Sharri” – struktura e pronësisë A2.2 Parku Kombëtar “Sharri” – harta topografike
A3	Vlerësimi i burimeve të ujit – regjenerimi, kërcënimet dhe kualiteti
A4	Vlerësimi i rreziqeve natyrore <ul style="list-style-type: none"> A4.1 Vlerësimi i rreziqeve natyrore – rreziku i erozionit A4.2 Vlerësimi i rreziqeve natyrore – rreziku nga ortekët A4.3 Vlerësimi i rreziqeve natyrore – rrëshqitja e dheut dhe zonat e prirura për vërshime
A5	Vlerësimi i bujqësisë dhe pyjeve <ul style="list-style-type: none"> A5.1 Vlerësimi i bujqësisë dhe pyjeve - gjendja e pyjeve A5.2 Vlerësimi i bujqësisë dhe pyjeve – funksionet e pyjeve A5.3 Vlerësimi i bujqësisë dhe pyjeve – kapaciteti produktiv i tokës A5.4 Vlerësimi i bujqësisë dhe pyjeve – bagëtitë dhe përshtatshmëria për të lashta
A6	Vlerësimi për mbeturinat e ngurta
A7	Vlerësimi i trashëgimisë kulturore dhe potenciali turistik
A8	Vlerësimi i shëndetësisë, shërbimeve mjekësore dhe mbrojtjes civile
A9	Vlerësimi i arsimit
A10	Vlerësimi i ekonomisë, infrastrukturës dhe energjisë <ul style="list-style-type: none"> A10.1 Vlerësimi i ekonomisë, infrastrukturës dhe energjisë – rrugëve dhe transportit

- A10.2 Vlerësimi i ekonomisë, infrasktrukturës dhe energjisë – energjia
- A10.3 Vlerësimi i ekonomisë, infrasktrukturës dhe energjisë – bizneset

G Hartat udhëzuese

Hartat udhëzuese që i referohen burimeve natyrore – parakushtet për PZhK

- G1-1 Konservimi i natyrës**
- G1-2 Zonimi i Parkut Kombëtar Sharri**
- G2-1 Pyjet**
- G2-2 Bujqësia**
- G3 Uji dhe kanalizimi**

Pjesët e hartave udhëzuese për PZhK – pjesa integrale e PZhK

- G4 Vendbanimet**
- G5 Rrugët dhe trafiku**
- G6 Arsimi**
- G7 Shëndetësia**
- G8 Turizmi**

IG Hartat e integruara udhëzuese

- IG1 Rezistenca hapësinore**
- IG2 Struktura funksionale**

6. Fjalorthi

Biodiversiteti	Shumëllojshmëria e organizmave të gjallë që përfshijnë shumëllojshmërinë brenda specieve dhe ndërmjet specieve të ndryshme, shumëllojshmërinë gjenetike dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.
CORINE Projekti për Sipërfaqen Tokësore (CLC)	CORINE qëndron për “Koordinimi i Informatave për Mjedisin” - DhST(CLC). Është një projekt pan-europian për të siguruar të dhëna të krahasueshme të caktuara për sipërfaqen tokësore për Europë.
Zonat zhvillimore	Zonat e zhvillimit të koordinuar: identifikimi i zhvillimit dhe përdorimit më të mirë pas balancimit të kujdesshëm ndërmjet kërkesave nga dhe konfliktet e mundshme ndërmjet sektorëve të ndryshëm dhe fushave kyçe.
NATURA 2000	Rrjeti i zonave të rëndësishme ekologjike të Bashkësisë Europiane të themeluara me Udhëzimin e Habitaveve (1992) dhe Direktiva e Zogjëve (1979)
Udhëzimi i Habitaveve (dhe Shtojca e)	Është një shprehje e shkurtuar për Udhëzimin e BE-së për Habitatet e Florës-Faunës (Udhëzimi i Këshillit 1996/105/EC) (gjithashtu quhet Udhëzimi HFF)
Korridori ekologjik	Komponenta ekologjike ose lidhja e disa komponenteve që lejojnë lëvizjen e lirë të organizmave nga një vend në tjetrin dhe janë pjesë përbërëse e rrjetit ekologjik.
Zonat e Mbrojtura	Zonat ku fushat kyçe (burimet) të ZhQ është e nevojshme të prezervohen ose mbrohen me qëllim që të sigurohet dispozicioni dhe funksioni i tyre për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme. Në këto zona të mbrojtura është çështja thelbësore e zhvillimit dhe përdorimit tjera në zonat e tilla duhet të harmonizohen me këtë objektivë.
Zonat e rehabilitimit	Zonat ku fushat kyçe (burimet) të ZhQ është e nevojshme të kanë përmirësim/ ngritje/ rritje të menjëhershme. Rasti mund të jetë i këtillë sepse statusi i tyre i tanishëm pengon procesin e zhvillimit. Në këto zona të rehabilitimit ekziston çështja thelbësore e zhvillimit.
ZVM	Zona e Veçantë e Mbrojtur (zonë e shpallur në përputhje me udhëzimet e BE-së për zogjët e egra, territoret më të përshtatshme në numër dhe madhësi për mbrojtjen e specieve të listuara në Shtojcën I dhe për speciet migruese që rregullisht paraqiten)
ZVK	Zona e Veçantë e Konzervimit (një vend i rëndësishëm së komunitetit i deklaruar nëpërmjet masave ligjore administrative, dhe/ose akt kontraktues kur masat e konzervimit të domosdoshëm zbatohen për të mirëmbajtur ose kthyer konservimin e habitaveve të natyrës dhe/ose popullatën e specieve për të cilat zona është shpallur të ketë status të favorshëm).

7. Literatura

- Master Plani për Bujqësi për Kosovë 2007 – 2013, www.ampkosovo.com/ - 4k
- Shoqata Shqiptare për Zhvillim të Qëndrueshëm të Energjisë dhe Mjedisit (AAEESD) (2006): Studimi i para-besueshmërisë për identifikimin nëse burimet e ujit mund të kanë përdorim nëpërmjet hidro-centraleve të vogla në Kosovë– Danida
- Antonijevic, D., M. Radivojevic (Editors) (1995): Šarr Mountain Župas, Gora, Opolje dhe Sredska. Vullumi II – Karakteristikat antropologjike-gjeografike-etnologjike, demografike, sociologjike dhe kulturore. Instituti Gjeografik i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve "Jovan Cvijić", Beograd
- Arneni, N.SH.T (2011): Raporti Final për Zonat Inventore të Pyjeve dhe ato Jo-Pyllore në Komunën e Dragashit, Raporti i UNDP-së, 14 faqe dhe shtojcat – Raporti i Dr. J. Milbradt për Zonat Inventore Pyjore dhe Jo-Pyllore në Komunën e Dragashit. Raporti i Projektit të UNDP-së.
- Bank P., F. Bemmerlein-Lux, E. Hajredini (2011): Metodologjia për Përcaktimin e Kufirit NP. Letra Punuese e UNDP-së; 5p
- Bemmerlein-Lux F. A., Ch. Dreiser, G. Werner (2008): Tregimi i Vendit të Qëndrueshmërisë – Atlasi për Udhëzimin e Zhvillimit të vet të Qëndrueshmërisë për Distriktin Kinez. Revista për Regjistrat e Zhvillimit Hapësinoro-Ekonomik (SDR) Vëll.15 Nën.3, fq 13-19
- Drini, B. (2009): Dragash/Dragaš Studimi Themelor – Drafti i Raportit Përfundimtar (UNDP)
- Komuna e Dragashit (2010): Plani lokal i veprimit mbi biodiversitetin në komunën e Dragashit 2011-2015, 16 pp
- ECNC, REC (2010): Plani Lokal i Veprimit mbi Biodiversitetin në Komunën e Dragashit – Komuna e Dragashit, Kosovë
- Elektroprojekt Consulting Engineers, Zagreb, (2009): Rishikimi i HPP Zhur Studimi i besueshmërisë përfshirë përgatitjet e ndikimit preliminary mjedisor dhe vlerësimi preliminary shoqëror
- Elezi Xhevdet (2011): Klasifikimi i cilësive tokësore në zonat bujqësore të Dragashit – harta e përshtatshmërisë për bujqësi. Raporti i UNDP-së 14 fq dhe shtojcat
- Esat Hoxha, M. Behxhet (2004a): Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura. Wus Austria
- Esat Hoxha; M. Behxhet (2004b): Ekologjia e Bimëve: Universiteti i Prishtinës, Kosovë
- EU (1985): CORINE land cover – Koordinimi i informatave mbi mjedisin (Gazeta Zyrtare L 176, 6.7.1985) <http://www.eea.europa.eu/publications/COR0>
- EU (2003): Udhëzimi 92/43/EEC Traktati i Hyrjes - SHTOJCA I: Llojet e Banimeve Natyrale në Interesa të Komunitetit, Mbrojtja e të cilave kërkon Përcaktimin e Zonave të Veçanta të Mbrojtjes
- EU (2007): Udhëzimi i banimeve – Udhëzimi i Këshillit 92/43/EEC i datës 21 maj 1992 mbi mbrojtjen e habitateve natyrore dhe faunës e florës së egër – Verzioni i konsoliduar 2007 (http://ec.europa.eu/environment/nature/legislation/habitatsdirective/index_en.htm)
- EU (2009): Udhëzimi i datës 30 nëntor 2009 mbi mbrojtjen e zogjëve të egër (2009/147/EC)
- EU (2010): Udhëzimi mbi Habitatet neni17 raporti – Përmirësimi i JETËS për përmirësimin e statusit të mbrojtjes së specieve dhe habitateve
- EULUP (2011): Prezentimi nga R. Palmer dhe N. Nordin: Ndjeshmëria nga erozioni i dheut dhe modelet e rreziqeve. Projekti "Mbështetja e mëtutjeshme për përdorimin e tokës " (EULUP) (gjithashtu shiqo <http://www.eulup-ks.org/>, modelin: http://www.eulup-ks.org/index.php?option=com_content&view=article&id=51%3Apresentations&catid=42%3Apatial-planning-and-environment&Itemid=70&lang=en) – qasja gusht 2012.



- Komisioni Europian (DG ENV B2) (2008a): MENAXHIMI i Habitaveve Natura 2000 - * Specie e pasura Nardus në tokat e barit 6230. Raporti teknik 2008 14/24 - Udhëzimi 92/43/EEC mbi mbrojtjen e habitaveve natyrale dhe florës e faunës së egër
- Komisioni Europian (DG ENV B2) (2008b): MENAXHIMI i Habitaveve Natura 2000 – Tokat e barit gëlqerore të Alpine dhe nën-alpine 6170. Raporti Teknik 2008 11/24 - Udhëzimi 92/43/EEC mbi mbrojtjen e habitaveve natyrale dhe florës e faunës së egër
- FAO (1984): Llojet e Përdorimit të Tokës
- FAO (1990): Udhëzimet për Përshkrimet e Tokave,
- FAO (2004): Pjesëmarrja në mënyrat e përdorimit të tokave në nivel komunal në Bosne dhe Hercegovinë, Llojet e Përdorimit të Tokave (LUT).
- FBRrZH, (2006): Studim besueshmërie për themelimin e Parkut Kombëtar nga ana Maqedonisë në Malin Sharr
- FINCHES (NGO) (2011):Lista e specieve të zogjëve dhe lokacioni i zogjëve në komunën e Dragashit. Raporti i UNDP, 6 faqe dhe shtojcat
- FSC (2010): Standardet e Kujdestarisë Pyjore për Republikën e Kosovës. Versioni 3.0 – Draft i aprovimit: Prishtinë, shtator 2010
- Hajriz M. (2009): Opojë. Prishtinë, 188 faqe
- Heath M. F., M. J. Endrus (2000): Zonat e rëndësishme të zogjëve në Europë, Vëllimi 2: Mbrojtja e jetës së Zogjëve në Europën Jugore , Seria Nr. 8
- Ibrahimi H. (2011a): Fauna Primare e Fluturave në Komunën e Dragashit. Raporti i UNDP, 8 faqe dhe shtojcat
- Ibrahimi H. (2011b): Vlerësimi i Kualitetit të Ujit nëpër Degët e Shpejta dhe Lumenjve në Komunën e Dragashit. Raporti i UNDP-së, 39 faqe dhe shtojcat
- Ibrahimi H. (2012a): Vlerësimi i Kualitetit të Ujit nëpër Degët e Shpejta dhe Lumenjve në Komunën e Dragashit. Raporti i UNDP-së, 39 faqe dhe shtojcat
- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (2006a): Harta Gjeologjike e Kosovës, Këshilli Qeverisës Prishtinë, Kosovë
- Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës (2003): Biodiversiteti i Sharrit, Komuna e Dragashit
- Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës, MMPH (2005): Vlerat e Trashëgimisë Natyrore të Kosovës.
- Instituti Për Planifikim Hapësinor, MMPH (2006): Analiza e Planifikimit Hapësinor në Dragash.
- Instituti Për Planifikim Hapësinor, MMPH (2008): Gjendja e Raporti Mjedisor, 2006-2007 Kosovë
- Instituti Për Planifikim Hapësinor, MMPH (2009): Drafti i Planifikimit Hapësinor, Parku Kombëtar “Mali i Sharrit”. Prishtinë
- Instituti për Mbrojtjen e Natyrës MMPH (2006): Biodiversiteti i Komunës së Dragashit, Kosovë
- KEK (2012): Të dhënat nga KEK-u Distribucioni Rajonal në Prizren 2012, të dhënat janë verifikuar dhe plotësuar me informata të më shumëta nga zyra e KEK-ut në Dragash
- Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit AKMM (2006): Biodiversiteti i territorit të Komunës së Sharrit; shkurt
- Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit AKMM (2008): Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit, 2006-2007
- Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit AKMM (2008): Raporti mbi Gjendjen e Natyrës, 2006-2007
- Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit AKMM (2010): Raporti mbi Gjendjen e Natyrës 2007-2009
- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (2012): Analizat e Ujërave të Zeza në komunën e Dragashit. Raporti i UNDP-së në gjuhën shqipe, 20 f. (Instituti Hidrometeorologjik I Kosvoes)



- Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (shkurt 2007): Biodiversiteti i Dragashit (Biodiversiteti i Komunës së Dragashit/Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës)
- Kuvendi i Kosovës (2004): Ligji për Mbrojtjen e Natyrës
- Lazarević, R. (1994): Zhupat e Maleve të Sharrit, Gora, Opoja dhe Sredska, Vëllimi I – Cilësitë e Mjedisit Natyror, Insitituti i Gjeografisë, Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve "Jovan Cvijic", Beograd. Forma e Hartës V. Antanacković, V. Tatić, Z. Krivošej faqe 241-241.
- MBPZhR-APK (2009): Plani për menaxhim të pyjeve, Njësia Menaxhuese Koritnik, përpiluar nga Zgjidhja për Resurset Natyrore (Libri 1, 101 f; Libri 2, 185 f), (Ministria e Bujqësis, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Pyjore e Kosovës: dokumenti zyrtar për menaxhim të pyjeve)
- MBPZhR-APK (2010a): Plani për menaxhim të pyjeve , Njësia menaxhuese Bredhiku, përpiluar nga Zgjidhja për Resurset Natyrore (Libri 1, 94 f; Libri 2, 194 f), (Ministria e Bujqësis, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Pyjore e Kosovës: dokumenti zyrtar për menaxhim të pyjeve)
- MBPZhR-APK (2010b): Plani për menaxhim të pyjeve , Njësia menaxhuese Opoja, përpiluar nga Zgjidhja për Resurset Natyrore (Libri 1, 125 f; Libri 2, 249 f), (Ministria e Bujqësis, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Pyjore e Kosovës: dokumenti zyrtar për menaxhim të pyjeve)
- MMPH/UNMIK (2006): Plani Hapësinor i Dragashit
- Milbradt, J. (2011): Të rehat kryesore të ekspertëve tonë për biodiversitetin dhe zonimit të parkut të propozuar kombëtar Dragash. "Arneni.P – consulting", Raporti UNDP, 4 pp dhe shtojcat.
- Millaku F. (2010): Inventori bimëve mjekësore dhe aromatike dhe manaferrave të egra në Kosovë. SAD Kosovë
- Millaku F., F. Rexhepi, Q. Pajazitaj, E. Krasniqi, Xh. Malaj (2011): II. Kontribuim i rëndësishëm me (203 specie bimore) në inventarin e bimëve për parkun kombëtar "Mali Sharr". Raporti preliminar për Listën e kuqe të specieve në Kosovë
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2006): Plani Kosovar i Veprimit për Mjedisin 2006-2010, Prishtinë
- Muhedin Nushi & Fatmir Selimi (SHKURT 2009): Vlerësimi i Konkurrentësisë së Zinxhirit të Ushqimit nga Blegtoria në KOSOVË. Analizat e Zgjerimit të Rrjetit të Politikave Bujqësore - Kordinator: Siemen van Berkum (LEI)
- Komuna e Dragashit , Art Gold UNDP (2010): Udhëzues Komunal i Dragashit për Bashkëpunim Ndërkombëtar 2011-2013
- Mustafa B. (1998): Karakteristikat themelore të Florës dhe vegjetacionit në Kosovës dhe rreziqet e Zhdukjes. Revista Shqiptare për Shkencat Natyrore dhe Teknike, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Shqipërisë, Tiranë
- Mustafa B. (2011): Profili Ekologjik i Specieve Bimore / Shoqatat dhe hartat Shpërndarëse për Komunitetet e Bimëve Specifike dhe Llojet e Habitave në Interes të Komunës së Dragashit, Raporti i Projektit të UNDP-së, 23 fq dhe shtojcat.
- Mustafa B. (2012): Statusi i Mbrojtjes së Biodiversitetit në Republikën e Kosovës me përqëndrim në qendrat e biodiversiteve. J. Environ. Biologjia 33 307-310
- Mustafa B., Esat. H. (2004): Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura. WUS-Austria-Universiteti i Prishtinës
- Mustafa B., H. Ibrahim (2009): Vlerësimi i kushteve të Biodiversitetit në Komunën e Dragashit dhe Rekomandimet për Mbrojtjen Ligjore– Raporti i UNDP-së, dhjetor 48 fq.
- Mustafa B., K. Georgev, A. Hajdari, E.Hajredini (2009): Menaxhimi i Qëndrueshëm i Pyjeve në Bashkësinë Europiane - EuropeAid/122672/D/SER/KOS Kontrata: CRIS 2008/162-109 - Identifikimi Preliminar i Vendeve Natyrore në Kosovë Natura 2000 - (Vendet kryesore të Biodiversitetit). 103fq.
- Nëntor (2006): Analiza hapësinore, Komuna e Dragashit (Spatial Planning Analysis of Dragash)
- Harta Pedologjike e Kosovës (1974)



- Pierre Galland, Tomasz Pezold, Ljudmila Dimtrova (2010): Vlerësimi i kushteve të biodiversitetit në komunën e Dragashit dhe rekomandimet për mbrojtjen ligjore: IUCN Beograd (Vlerësimi i situatës së biodiversitetit në Komunën e Dragashit dhe rekomandime për mbrojtje ligjore)
- Pireci M. (2010 dhe 2012): Raporti për Vlerësim të Energjisë të Komunës së Dragashit, mars
- Rregullore për masat e verifikimit të lërueshmërisë së veçantë të vlefshme (P1) dhe lërueshmërisë së vlefshme (P2) të tokës bujqësore (2010): Ministria e Bujqësisë, Peshkimit dhe Zhvillimit Rural, Republika e Kroacisë.
- Republika e Kosovës – Departmenti i Mbrojtjes së Mjedisit (2010): Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 2011 – 2020. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Republika e Kosovës, 70 fq përfshirë shtojcat
- Republika e Kosovës (2006):Ligji mbi Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26
- Republika e Kosovës (2008): Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetë-Qeverisjen Lokale
- Republika e Kosovës (2010): Ligji mbi amendamentet në Ligjin Nr. 2003/3 mbi Pyjet e Kosovës (mars 2010): Viti V / Nr. 67/29 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë
- Republika e Kosovës (2010):Ligji mbi Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L–233
- Republika e Kosovës (2011): Ligji mbi Arsimin Para-Universitar Nr.04/L–032
- Republika e Kosovës (2012): Ligji draft mbi Parkun Kombëtar “Sharri”. Kuvendi i Republikës së Kosovës, 18 fq
- Rexhepi F. (1994): Vegjetacioni i Kosovës. Fakulteti i Shkencave Natyrore në Prishtinë, Kosovë
- Rexhepi F. (2003): Bimët Mjekësore. USAID
- Rugova, Ibrahim H., et al (2008): “Rëndësia e hulumtimit të makrosistemeve në Kosovë dhe monitorimi biologjik i ekosistemeve ujore në Kosovë”, Tryezë shkencore – Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës. ,Buletini i Akademisë
- Strauss A. and Pezold, T. (compilers) (2009): *All Along the Watchtowers: Udhëzues terreni për Rrypin e Gjelbërt në Europën Jug-Lindore*. Beograd, Serbia: IUCN Programi, Zyra për Europë Jug-Lindore. viii + 78 fq.
- Tush Markaj (2010): Vlerësimi i sektorit ujor në komunën e Dragashit - Raport (Raport: Vlerësimi i sektorit të ujit në Komunën e Dragashit/Tush Markaj, Mars, 2010)
- UNDP (2010): Udhëzimet për Komunën e Dragashit për Bashkëpunimin e Decentralizuar, 2011-2012
- UNDP (2011): Pyetësori për fshatra – mbledhja e brendshme e të dhënave
- UNDP (2012a): Pasuritë e Trashëgueshme Kulurore në Dragash. Raporti nga Crystal Whitaker, gusht 2012 – 72 fq.
- UNDP (2012b): Projekti i Dragashit: Raport mbi kualitetin e ujit të pijshëm në 35 fshatra dhe në komunën e Dragashit – analiza e të dhënave e bërë nga Instituti Kombëtar për Shëndet Publik i Kosovës
- UNEP Vienë ISCC (2006): Përforcimi i Menaxhimit të Biodiversitetit Ndër-kufitar në Europën Jug-Lindore
- UNEP Vienë ISCC (2009): Studimi i fizibilitetit në krijimin e zonës së mbrojtur ndër-kufitare në Malin e Sharrit – Korab – Deshat, 62 fq
- USAID Kosovo (2003): Vlerësimi i Biodiversitetit në Kosovë. ARD-BIOFOR IQC Konsorciumi Kosovë – Raporti Final i dorëzuar tek Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, 29 fq dhe shtojcat
- Visar Morina (2010): Konfliktet mbi pronësinë e tokave që ose janë duke ndodhur ose do të mbyllen në të ardhmen e afërt në Dragash;

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Atlas për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Dragashit -Kosovë



Vlaire Hajaj (2011): Raporti i Zhvillimit Njerëzor

Wassel, T. (2011): Malet e Dragashit, Kosovë: Udhërrfyes për Shëtitje dhe Turizëm në Natyrë. UNDP – 100 fq (Versionet në Anglisht, Shqip dhe Serbisht)

Draft final - për miratim